



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 245/prot.

Pogradec, më 03.06 .2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

ZNJ. MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projektvendimin dhe relacionin shoqërues, për: *"Miratimin e hartës të hapësirave publike në Bashkinë Pogradec"*.

Me respekt,

KRYETARI

Hir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: _____
Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: _____
Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2026

PROJEKTVENDIM
NR. ____ , DATË ____ . ____ .2026
PËR

MIRATIMIN E HARTËS TË HAPËSIRAVE PUBLIKE NË BASHKINË POGRADEC

Në mbështetje të nenit 23, pika 14, nenit 54, shkronja "k" të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 4/1 të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar, Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, VKM nr. 224, datë 1.4.2026 "Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike", relacionit të Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë hartën e hapësirave publike në territorin e Bashkisë Pogradec, sipas materialit hartografik bashkëlidhur.
2. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 105, datë 02.12.2021 për "Miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave publike" dhe "Harta që përcakton rrugët e qytetit ,të cilat përjashtohen nga kjo rregullore", shfuqizohet.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policia Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

KRYETARE
Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E P. K. ZH. T

Nr. 2408/prot.

Pogradec, më 03.06 .2026

RELACION

Në lidhje me Projekt -Vendimin për "*Miratimin e hartës të hapësirave publike në Bashkinë Pogradec*",

E nderuar Kryetare e Këshillit!

Të nderuar Këshilltarë!

Më datën 14.04.2026 është botuar në Fletoren Zyrtare, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 224, datë 1.4.2026 "Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike", i cili shfuqizoi Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1096, datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike".

Vendimi është miratuar në bazë dhe në zbatim të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe përcakton qartë rregullat, kushtet, kriteret dhe procedurat e detajuara për shfrytëzimin e hapësirës publike, të unifikuara për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në përmbajtje të tij, akti normativ përcakton detyrime të qarta për njësitë e vetëqeverisjes vendore në lidhje me hartimin, miratimin dhe administrimin e instrumenteve konkrete për menaxhimin e hapësirave publike, ndër të cilat përfshihet edhe hartimi i hartave përkatëse.

Në pikën 3 të nenit 9 të vendimit përcaktohen përgjegjësitë e Këshillit Bashkiak:

"1. Këshilli bashkiak miraton tarifën e zënies së hapësirave publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për taskat dhe tarifën vendore, si dhe financat e vetëqeverisjes vendore. Ai gjithashtu përcakton destinimin e të ardhurave për shërbime mirëmbajtjeje apo investime publike në funksion të përmirësimit të hapësirave publike.

2. Me kërkesë të subjektit aplikues, për afate më të gjata se ai i përcaktuar në nenin përkatës, këshilli bashkiak mund të miratojë leje për shfrytëzimin e hapësirave publike për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet. Këto leje jepen në përputhje me tarifën e miratuar dhe mbi bazën e raporteve të strukturës përgjegjëse. Përjashtim bën vendosja e veprave artistike ose përkujtimore, për të cilat këshilli mund të lejojë shfrytëzimin e hapësirës publike për afate më të gjata se 5 (pesë) vjet.

3. Këshilli bashkiak miraton politikën e përgjithshme për menaxhimin e hapësirave publike, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

4. Këshilli bashkiak miraton rregullat dhe procedurat për shfrytëzimin e hapësirave publike në zbatim të këtij vendimi, brenda territorit administrativ të bashkisë.

Në këtë kuadër ligjor dhe institucional, hartimi dhe miratimi i hartës së hapësirave publike për Bashkinë Pogradec përbën një domosdoshmëri për garantimin e një administrimi të rregullt, transparent dhe të standardizuar të këtyre hapësirave, si dhe për rritjen e efikasitetit në përdorimin e tyre nga subjektet dhe qytetarët.

Projektvendimi i paraqitur për miratim synon evidentimin dhe klasifikimin e hapësirave publike në territorin e Bashkisë Pogradec, si dhe rritjen e transparencës dhe kontrollit në administrimin e hapësirave publike.

Në përfundim, projektvendimi "Për miratimin e hartës së hapësirave publike në Bashkinë Pogradec", paraqitet për shqyrtim dhe miratim, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe në funksion të përmirësimit të menaxhimit të hapësirave publike në territorin e bashkisë.

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, "Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj."

Në vijim, ligji nr. 197/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, në nenin 4, pika 1, përcakton se:

"Akte me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore."

Gjithashtu, në nenin 8, shkronja "a", të këtij ligji përcaktohet se Prefekti ushtron kompetencën për verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Akti nënligjor normativ përbën një nga format përmes të cilave autoritetet e pushtetit shtetëror, përfshirë edhe organet e vetëqeverisjes vendore, rregullojnë me norma të përgjithshëm çështje të lidhura me ushtrimin e funksioneve të tyre.

Bazuar në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", neni 3, pika 2, përcakton se:

"Akti normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij."

Ndërsa neni 3, pika 1, shkronja "a", e këtij ligji:

a) "Akti administrativ individual" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;



b) "Akti administrativ kolektiv" është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektesh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që i drejtohet një numri të pacaktuar subjektesh.

Në rastin konkret, projektvendimi në shqyrtim plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 2 e ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", pasi përbën një akt nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili nuk shteron me zbatimin e tij dhe prodhon pasoja juridike të përgjithshme në territorin e Bashkisë Pogradec, duke iu drejtuar një numri të pacaktuar subjektesh.

Gjatë zbatimit të tij, ky akt shtrin efektet në të gjithë hapësirat publike të Bashkisë Pogradec dhe ndaj çdo subjekti që përfshihet në fushën e tij të veprimtimit.

Përfundimisht, vlerësohet se projektvendimi ka natyrë normative dhe si i tillë i nënshtrohet verifikimit të ligjshmërisë nga Prefekti Qarkut Korçë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim!

Të dhënat e projekt vendimit:

Konceptoi: Marjano Tasellari, Përgjegjës Sektori

Miratoi: Paskalino Ziko, Drejtor i D.P.K.ZH.T

Konfirmoi: Dritan Babasuli, Sekretar i Përgjithshëm

Përcaktoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik:
Jurist i Drejtorisë së Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit: Taulant Fejzo

KRYETAR
Ilir XHAKOLLI



Table Of Contents

- Layers
- tavolinat
- PEMPVO
- LOCATION
- PRUGET
- LODRAT
- SHTEPITE E DRURIT
- SHTEPITE E DRURIT
- TROTUAR
- <all other values>
- KALM_BIZN
- BIZNES
- KALIMTAR
- NUK LEJOHET
- SHESH
- TRAVOLIMAT
- TROTUAR
- shesnet
- Urat
- PEDANAT-10 m
- UAV_Orto_2024_202



Republika e Kosovës Qeveria e Kosovës Instituti i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (IPZT)	Objekti:	SHFRYTEZIMI I HAPSIRAVE PUBLIKE POGRADEC	
	Emri:	Planimetri te hapsirave publike	
Drejtori Ark. Ferit Daci	Ark.	Mariano Tasella	
	Spec. Trogre	Dea Dagermeni	
			PL



Table Of Contents

- Layers
- travolinat
- PERIPTO
- LOCATION
- RRUGET
- LODRAT
- SHITESITE E DRURIT
- SHITESITE E DRURIT
- TRQ PUAJET
- <all other values>
- KALIM_BIZN
- BIZNES
- KALIMTAR
- NUK LEJOHET
- SHESH
- TAVOLINAT
- TROTUAR
- cheshet
- Urat
-
- PEDANAT-10 m
- UAV_Orto_2024_2025



Bashkia e Pogradecit Drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territoreve Mësoni Pogorec Drejtor	Objekti: SHFRYTEZIMI I HAPSIRAVE PUBLIKE POGRADEC	
	Emorimi: Planimetri të hapsirave publike	
Ark. Spec.Tipografi	Mariano Tasellari Dea Degermeni	

- Table of Contents
- Layers
 - tavolinat
 - PERIPTO
 - LOCATION
 - RRUJET
 - LODRAT
 - SHTEPITE E DRURIT
 - SHTEPITE E DRURIT
 - TROTUARET
 - < all other values >
 - KALM_BIZN
 - BIZNES
 - KALIKITAR
 - NUK LEJOHET
 - SHESH
 - TAVOLINAT
 - TROTUAR
 - sheshet
 - Urat
 - PEDANAT-10 m
 - UAY_Orto_2024_202



Miratoj Paqarac Dergje e Hapësirave Publike dhe Zhvenditje Territoriale	Qyteti: SHFRYTEZIMI I HAPSIRAVE PUBLIKE POGRADEC	
	Emri i Planit: Planimetri të hapsirave publike	
Drejtori Ark. Paskalis Zibo	Ark.	Mariano Tasellari
	Spec. Të përgj.	Desa Degermeni



Table Of Contents

- Layers
- Involinat
- PERIPTO
- LOCATION
- RRUGJET
- LODRAT
- SHTEPITE E DRURIT
- SHTEPITE E DRURIT
- TROTUAR
- call other values:
- KALIM_BIZN
- BIZNES
- KALIMTAR
- NUK LEJOHET
- SHESH
- TAVOLINAT
- TROTUAR
- sheshet
- Urrat
- PEDANAT-10 m
- UAV_Orto_2024_202



Bashkia Pogradec Shërbimi i Hapësirave Publike dhe Zhvillimit të Territorit www.pogradec.gov.al	Objekti:	
	SHFRYTEZIMI I HAPSIRAVE PUBLIKE POGRADEC	
Nr. 10/2024 Art. 10, paragrafi 2 i 1	Emërtimi:	
	Planimetri të hapësirave publike	
Nr. 10/2024 Art. 10, paragrafi 2 i 1	Ark.	Mariano Tasellari
	Spec. Topogr.	Dea Degermeni